



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Shtimes



Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Shtimes 2016-2021

Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Shtimes 2016-2021

Rigjallërimi i hapësirave ekzistuese, krijimi i hapësirave të reja dhe monitorimi i tyre për Komunën e Shtimes me Hapësira të Hapura Publike të sigurta, të qëndrueshme dhe tërheqëse për qytetarë dhe vizitorë.

Falënderimet

Ky plan është përgatitur nga grupi punues i komunës së Shtimës, bartëse e të cilës është Drejtoria për shërbime publike në mbështetje dhe bashkëpunim të ngushtë me grupin koordinues, zyrtarët e projektit si dhe konsulentet përgjegjës të projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation e financuar nga Zyra Zvicërane për bashkëpunim (SCO) të cilët i falënderojmë për kontributin e dhënë. Grupi punues dhe koordinues për hartimin e planit të mirëmbajtjes dhe planit të investimeve të hapësirave të hapura publike në Komunën e Shtimës, kanë bërë identifikimin e hapësirave të hapura publike në terren si dhe planifikimin e aktiviteteve të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre.

Grupi Punues

1. **Ardiana Rama-Gashi**- koordinatorë
2. **Mehdi Salihu**- anëtar
3. **Shqipe Rexhaj**- anëtare
4. **Albulena Emini**- anëtare
5. **Sabri Çerkini** - anëtar
6. **Adem Bajrami**- anëtar

Grupi Kordinues

1. **Ardiana Rama-Gashi**- Drejtoreshë e Drejtoratit për Shërbime Publike
2. **Kimete Ferati-Ukaj**- zyrtare për Buxhet dhe Financa
3. **Mehdi Salihu**- Drejtor i Drejtorisë për planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Ekipi përkrahës

1. **Besnik Keka**- Këshilltar lokal, CDF/DEMOS
2. **Teuta Jaha-Hoxha**- Zyrtare e projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation
3. **Majlinda Jupolli**- Zyrtare e projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	5
1.1. Profili i Komunës	5
1.2. Funksionet e HHP	5
1.3. Fushëveprimi i planit të mirëmbajtjes së HHP	6
<i>Përcaktimi i HHP të cilat përfshihen në Planin e Mirëmbajtjes</i>	<i>6</i>
1.4. Parimet udhëheqëse.....	7
1.5. Dokumentet referuese.....	7
<i>Korniza ligjore</i>	<i>7</i>
<i>Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018</i>	<i>8</i>
2. Gjendja e tanishme dhe analiza E Hapësirave të Hapura Publike	9
2.1. Gjendja e tanishme e HHP	9
<i>Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP.....</i>	<i>10</i>
<i>Të dhënat themelore për HP (parqe dhe rekreacion)</i>	<i>10</i>
<i>Cilësia e HHP ekzistuese</i>	<i>11</i>
<i>Shfrytëzimi i HHP.....</i>	<i>11</i>
<i>Shfrytëzimi i HHP.....</i>	<i>12</i>
2.2. Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP	12
2.3. Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HP në tri vitet e kaluara.....	13
2.4. Të dhënat grafike dhe tabelore mbi HHP ekzistuese	14
2.5. Analiza e aktiviteteve të mirëmbajtjes për fushat e mirëmbajtjes.....	16
3. Vizioni, objektivat dhe strategjia mbi HP.....	16
3.1. Vizioni i komunës mbi HHP	16
<i>Deklarata e vizionit për komunën e Shtimes nga PZHK.....</i>	<i>16</i>
<i>Deklarata e vizionit për mirëmbajtjen e HHP për Komunën e Shtimes.....</i>	<i>16</i>
3.2. Synimet dhe objektivat për mirëmbajtjen e HHP.....	16
4. Plani financiar.....	17
<i>Tabela përmbledhëse e mirëmbajtjes vjetore të HHP</i>	<i>18</i>
<i>Kostot e bazuara në periudhën e vitit.....</i>	<i>18</i>
<i>Mirëmbajtja mujore -2016.....</i>	<i>18</i>
4.1. Nevoja për buxhet të ri për mirëmbajtje të vazhdueshme.....	19
4.2. Rrjedha e parasë (cash flow) e kostove të mirëmbajtjes dhe përlogaritja e kostove të sezonit.....	22
4.3. Kostot e mirëmbajtjes për periudhën e planit 2016-2019	23
5. Ndërgjegjësimi publik	26
5.1. Strategjia komunale për aktivitetet me komunitetin.....	26
<i>Aktivitetet.....</i>	<i>27</i>
<i>Stimulimi i “Lokalitetit më të mirëmbajtur”</i>	<i>27</i>
6. Monitorimi dhe rishikimi	27
<i>Plotësimi dhe rishikimi i PMHHP</i>	<i>28</i>
SHTOJCAT	30

1. HYRJE

1.1. Profili i Komunës

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës apo në koordinatat 42.43, 21.03. Territori i Komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km² (13,450.8 hektarë), gjegjësisht 1,2 % të territorit të Kosovës.

Afër 48,4 % e territorit të komunës është tokë bujqësore dhe bujqësia është një nga prioritetet zhvillimore të komunës. Komuna e Shtimes numëron rreth 27,324 banorë (statistikë e marrur nga Regjistrimi i Popullsisë në vitin 2011 për banorë rezident), ku rreth 73.8 % e popullatës jeton në fshatrat e komunës. Komuna ka 23 vendbanime, duke përfshirë qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore – malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore. Të gjitha fshatrat e komunës janë të lidhura me Shtimen me rrugë të asfaltuara.

Vetëm në qytetin e Shtimes jetojnë rreth 7107 banorë ose 26.2% e K. të Shtimes. Kryqëzimi i akseve rrugore të rëndësishme në relacionet Prizren - Prishtinë dhe Prizren-Ferizaj-Shkup janë segmente më me rëndësi për zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës. Komuna e Shtimes kufizohet me Komunën e Ferizajt, Shtimes dhe Therandës (Suharekës). Qyteti i Shtimes është 31 km larg nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina), 48 km nga Prizreni dhe 13 km nga Ferizaj. Shtimja është udhëkryq i rrugëve regjionale.

Mirëmbajtja e Hapësirave publike është përcaktuar si një nga tri shtyllat kryesore të politikave komunale. "Planifikimi i mirë hapësinor dhe rregullues dhe ndërlidhja e Hapësirave të Hapura Publike kontribuon në gjallërimin e komunës dhe krijon mundësi për aktivitete formale dhe joformale të rikrijimit."

1.2. Funksionet e HHP

Si Hapësira të Hapura Publike i referohemi hapësirave me mundësi qasje nga publiku të cilat janë të destinuara për aktivitete formale, joformale, aktivitete rikrijuese, kulturore dhe funksione të tjera për komunitetin. Hapësirat e Hapura Publike, si asete komunale, promovojnë komunitete të shëndetshme.

1. Përjetim i natyrës: një mundësi për qytetarët që të përjetojnë mjediset e pasura dhe natyrore, arkeologjike, etj.
2. Rekreacion: ofrim i mundësive të llojllojshme për rekreacion në mjedise natyrore; ecje, vrapim, çiklizëm, tubime shoqërore dhe ngjarje kulturore.
3. Edukim: HP mund të shërbejnë edhe si klasa natyrore me mundësi mësimi dhe hulumtimi me nxënës dhe fëmijë të grupmoshave të ndryshme.
4. Projektim urban: mjediset përgjatë HP karakterizohen me kufizime në zhvillimet ndërtimore dhe ofrojnë peizazhe dhe vizura të mira, definojnë kufijtë urban, si dhe dekurajojnë zgjerimet e pakontrolluara urbane.

5. Krijimi i trashëgimisë: ruajtja e tipareve të rëndësishme të mjedisit natyror të qytetit të Lipjanit është prioritet i lartë për qytetarët dhe për ambiciet programore lidhur me shtretërit e lumenjve, korridoret e gjelbra, ato hekurudhore, rrugore, etj.
6. Organizime kulturore, edukim i publikut për ruajtjen e natyrës dhe ambientit dhe ngritjen e ndërgjegjësimit qytetarë.
7. Funksionet rregulluese mikroklimatike, ruajtja e llojloshmërisë së florës dhe faunës, balancim i CO2, motivim dhe inspirim për kulturë, art, etj.

Bartës i projektit është Komuna e Shtimes, respektivisht Grupi Drejtues. Hartues i planit për Mirëmbajtjen e HHP dhe të Planit të Investimeve është Komuna e Shtimes, gjegjësisht grupi punues i mbështetur nga DEMOS.

1.3. Fushëveprimi i planit të mirëmbajtjes së HHP

Në planin e mirëmbajtjes së HHP janë të përfshira parqet, sheshet, varrezat dhe jo e gjithë hapësira përreth, si p.sh. rrugë apo trotuar. Tregjet, terrenet sportive (aktualisht nuk përfshihen në planin e mirëmbajtjes së HHP për arsye se tregjet menaxhohen nga Shoqata e Veteranëve të Luftës, terrenet sportive janë brenda hapësirave shkollore dhe menaxhohen nga vetë shkolla, ndërsa fushat tjera sportive janë jashtë objekteve shkollore dhe menaxhohen nga klubet sportive. Plani hartohet për periudhën afatmesme 2016-2021.

Përcaktimi i HHP të cilat përfshihen në Planin e Mirëmbajtjes

Plani i mirëmbajtjes dhe ai i investimeve për periudhën është hartuar për periudhën afatmesme. Në periudhën e parë të zbatimit është vendosur të inkuadrohen hapësirat si në vijim:

Tabela 1: HHP të përfshira në PM

Parqet		Sheshet		Varrezat	
1	Ahmet Shtimja	1	Sheshi i UÇK-së	1	Varrezat e Dëshmorëve dhe Veteraneve në Shtime
2	Muzeqinë	2	Sheshi i Dëshmorëve	2	Varrezat Muslimane
3	Petrovë			3	Varrezat Ortodokse
4	Rashincë			4	Varrezat e Dëshmorëve në Mollopolc
5	Pishave			5	Kompleksi Memorial në Reçak
6	QKMF				
7	K. Kumanova				
8	Parku te qendra rinore				
9	Drurende përgjatë trotuareve				

Përveç hapësirave të lartcekura, element karakteristik për pjesën urbane të Qytetit të Shtimes janë edhe drurendet përgjatë rrugëve kryesore.

Në rishikim, plani do të përfshijë hapësira tjera të hapura publike, varësisht nga nevojat/kërkesat dhe mundësitë buxhetore. Varësisht nga përmbajtja e hapësirave publike, janë evidentuar fushat kryesore sa i përket aktiviteteve të nevojshme për mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike.

Bazuar në inventarizimin dhe analizimin e frekuencës së shfrytëzimit, identifikohen HHP-të me shkallë të prioritetit të mirëmbajtjes dhe të investimeve. Inventarizimi është bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Urbanizëm duke shfrytëzuar softuerin QGIS.

1.4. Parimet udhëheqëse

Komuna e Shtimes ka miratuar *Planin Zhvillimor Komunal*, *Planin Zhvillimor Urban*, si dhe *Planin Rregullues Urban* për qytetin e Shtimes. Në këto dokumente, mirëmbajtja e hapësirave të hapura publike në përgjithësi është trajtuar shumë pak. Në kuadër të këtyre planeve janë trajtuar në masë më të madhe vend ndaljet e autobusëve dhe parkingjet për lokalitete të ndryshme. Në vijim janë paraqitur disa nga objektivat komunale të parapara në kuadër të këtyre planeve, të cilat e trajtojnë hapësirën në përgjithësi.

1.5. Dokumentet referuese

Korniza ligjore

Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike për komunën e Shtimes është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve së Shtimes, sepse ndërlidhet me nevojat e banorëve, organizimin e hapësirave gjelbëruese në qytete dhe fshatra, si dhe me kualitetin e jetës. Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike për komunën e Shtimes bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë, si dhe parimet dhe konventat ndërkombëtare të cilat janë të ndërlidhura me mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike, si:

- Rregullorja Komunale për Shërbime Publike 01 Nr. 06/4067, datë 30.12.2005;
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligji për Planifikim Hapësinor;
- Plani Zhvillimor Komunal 2009-2020;
- Plani Rregullues Urban për qytetin e Shtimes;
- Plani Zhvillimor Urban 2009-2020;
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018;
- Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018;
- PLVM (Të vërtetohet nga komuna nëse Komuna e Shtimes ka hartuar PLVM dhe nëse komuna ka hartuar PLVM, të përfshihet në dokument)

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përshkruan bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse. Në kuadër të ligjit për vetëqeverisje lokale, janë caktuar të drejtat në nivel lokal, si e drejta për:

- zhvillimin lokal ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; mbrojtjen e mjedisit lokal; janë kompetencat vetanake, të plota dhe ekskluzive, sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe këto kompetenca janë përcaktuar në nenin 17 të ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Ligji për Planifikim Hapësinor ka për qëllim rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban. Në kuadër të këtij ligji, planifikimi hapësinor duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të Kosovës dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm; po ashtu duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet.

Sipas ligjit për planifikim hapësinor, parashihet që ekspertiza profesionale të integrohet në sistemin e planifikimit duke e themeluar komisionin e ekspertëve të planifikimit (në nivelin lokal). Në Kosovë ekzistojnë dy nivele të planifikimit (kombëtare dhe lokale) dhe llojet e planeve janë: plani hapësinor i Kosovës, planet hapësinore për zona të posaçme, planet zhvillimore komunale (PZHK), planet për zhvillim urban dhe planet rregulluese urbane.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit cakton shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar, përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Rregullorja Komunale për Shërbime Publike - Qëllimi primar i kësaj rregullore është përmirësimi i kushteve jetësore të qytetarëve, rregulli, qetësia dhe rendi komunal, pamja sa më e bukur e qytetit dhe vendbanimeve tjera, mbrojtja e ambientit jetësor, si dhe mirëmbajtja dhe shfrytëzimi sa më racional i objekteve publike dhe institucionale. Me këtë rregullore synohet të përcaktohen kushtet e përgjithshme për kryerjen e veprimtarive komunale, mirëmbajtja dhe mbajtja e higjienës në hapësirat publike, si dhe të caktohen detyrat dhe obligimet e qytetarëve, ekonomive familjare, bashkësive të ndryshme, shoqatave, bizneseve, ndërmarrjeve, institucioneve, organeve të administratës lokale, si dhe subjekteve tjera për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike në qytetin e Shtimes, e në veçanti të caktohen kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë e higjienës në vendbanime periferike dhe në tërë territorin e Komunës së Shtimes.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018

Korniza Afatmesme Buxhetore për Komunën e Shtimes është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Kosovës dhe është hartuar në përputhje me procedurat buxhetore 2016/2018 dhe të dhënat nga MF përmes qarkores buxhetore 2016/01.

8. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Në KAB Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave–prioriteteve të tanishme dhe afatmesme të Shtimes, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitin 2016-2018.


2. GJENDJA E TANISHME DHE ANALIZA E HAPËSIRAVE TË HAPURA PUBLIKE

2.1. Gjendja e tanishme e HHP

Inventarizimi i HHP është bërë nga zyrtarët pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, përkrahur nga Drejtoria e Urbanizmit dhe DEMOS. Identifikimi i HHP është bërë duke përdorur QGIS, ndërsa veçoritë (atributet) e HHP janë plotësuar në forma tabelore, bazuar në përvojën paraprake të zyrtarëve komunal.

Rezultatet e këtij inventarizimi të detajuar janë paraqitur në hartat tematike të krijuara në QGIS si dhe në formë tabelore (shtojcë), të punuara gjatë sesioneve të rregullta me konsulentët e projektit DEMOS.

Figura 1: Shtime: Zona Urbane



Në të njëjtat janë paraqitur HP me atributet sipas tipologjisë, madhësisë, kualitetit, si dhe sipas frekuentimit nga ana e qytetarëve. Numri i banorëve që ndërlidhet me pjesën e frekuentuar të HHP me atë të identifikuar me softuerin QGIS është rreth 15.000 banorë. Ndërsa sipërfaqja e HHP është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 2: Sipërfaqet e HHP

Parqe (m²)	216445
Drurende	2892 m’ (168 Drunjë)
Sheshe (m²)	620
Varreza (m²)	73203

Aktualisht, komuna, me një buxhet të limituar, përkujdeset për mirëmbajtjen e këtyra hapësirave me dy kontrata, të cilat komuna i ka lidhur me dykompani. Njëra është kompani regjionale dhe tjetra private. Tendenca është që mbas hartimit të këtij plani të rritet pjesa e buxhetit në mirëmbajtjen e tyre.

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP

Nga inventarizimi i përmendur, për të pas idenë për sipërfaqet aktuale të HP për qytetaret e Sh-times, janë marrë të dhëna mbi sipërfaqet e HP për kokë banori, të cilat janë treguar në tabelën e mëposhtme. Parkingjet dhe tregjet e gjelbra nuk janë trajtuar në këtë dokument.

Tabela 3: Sipërfaqet për rekreacion pasiv dhe aktiv

HP sipas tipologjisë	Sipërfaqja në ha (m²)	Nr. i banorëve	Sip. e HP në m² / ban.
Parqe / Gjelbërime	216445		
Sheshe	620		
Gjithsej HP në m²	25489	(7107)15000	(30.54) 14.47

Tabela 4: Sip. e ndërtuara dhe të tjera

HP sipas tipologjisë	Sipërfaqja në ha (m²)
Parkingje	N/A
Tregje të gjelbra	N/A
Varreza	41559
Sipërfaqet agrare (PZHU)	6135747 (613.57 ha)
Gjithsej HP në m²	

Të dhënat themelore për HP (parqe dhe rekreacion):

- Sipërfaqja aktuale e HP për rekreacion aktiv dhe pasiv, 30.54 m2/ban. (tab. 1).
- Sipërfaqet aktuale në aspektin e qasjes, me fokus në largësinë (distançë – kohë), janë paraqitur në hartat tematike.
- Ndërlidhja e HP me korridore të gjelbra, shtigje, etj. Në këtë moment mund të pohohet se vërtetë HHP janë të mjaftueshme, por jo me mbulueshmëri të duhur dhe jo të ndërlidhura mirë; mirëpo, është synim i Komunës së Shtimes që në një plan afatgjatë të ofrojë të njëjtat në një nivel standard të dëshirueshëm.

Standardet e synuara/të parapara në planet komunale janë adaptuar edhe në PMHP; qeveria komunale synon të ofrojë HP për rekreacion aktiv dhe pasiv në numër dhe sasi të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e qytetarëve me përmbajtje natyrore, sheshe, shtigje, hapësira tjera të shpërndara në aspektin hapësinor ashtu që të jenë afër qytetarëve. Standardi i synuar kuantitativ i HHP në plan afatgjatë është ruajtja e Sipërfaqeve të Hapura Publike ekzistuese dhe krijimi i sipërfaqeve të reja, në veçanti në zonën rurale.

Cilësia e HHP ekzistuese

Standardet kuantitative/HHP kualitative promovojnë ruajtjen e shëndetit fizik dhe mendor. Mundësia për aktivitete fizike, qofshin ato aktive apo pasive, për pjesëmarrësit do të jetë e dobishme në aspektin fizik, shoqëror dhe psikologjik, duke rezultuar në reduktim të tensionit, stresit të përditshëm, në promovimin e jetës së shëndoshë të qytetarëve, si dhe në stabilitetin e lagjeve.

Është vlerësim i përgjithshëm se në mungesë të një plani adekuat, por edhe për shkak të kapaciteteve të kufizuara buxhetore, HHP në të kaluarën nuk janë mirëmbajtur në nivel të duhur.

Dokumentacioni fotografik për HHP në Komunën e Shtimes.

Shfrytëzimi i HHP

Figura 2: HHP sipas frekuentimit



Shfrytëzimi i HHP

Sipas përdorimit, HP në përgjithësi janë klasifikuar në ato me përdorim të shpeshtë, mesatar dhe HP të cilat nuk përdoren fare.

Tabela 5: Frekuentimi i HHP

Frekuentimi i HHP		
Frekuentim i lartë	Frekuentim mesatar	Frekuentim të ulët
Parku Ahmet Shtimja	Parku i Pishave	Parku në Muzeqinë
Parku QKMF	Parku në Petrovë	Parku në Rashnicë
Parku “K.Kumanova”	Sheshi i Dëshmorëve	
Sheshi UÇK-së		

2.2.Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP

Në të kaluarën si edhe tani, mirëmbajtja e HP është bërë me kontrata shërbimesh të dhëna operatorëve të kontraktuar nga jashtë, gjegjësisht kontrata kornizë me afat tre vjeçar. Nga mangësitë e shumta të identifikuara në to mund të përmenden:

- mangësi në ndarjen e zonave/fushave të mirëmbajtjes,
- mangësi në aktivitetet e parapara të mirëmbajtjes,
- përshkrime jo koncize të aktiviteteve të mirëmbajtjes,
- mungesë e specifikimeve teknike,
- mangësi në planifikim dhe në dinamikën e mirëmbajtjes, etj.

Mangësitë e përmendura më lartë kanë vënë në pyetje edhe rëndësinë e çmimeve të ofertuara në kontratat e mëhershme, ndërsa si pasojë edhe monitorimi i mirëmbajtjes ka mundur të jetë i vështirësuar.

Drejtoria për Shërbime Publike është përgjegjëse për menaxhimin e kontratës për mirëmbajtjen e HHP në Komunën e Shtimes. Inspektimi i cilësisë së shërbimeve bëhet nga inspektorati për mjedis në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike nëpërmjet monitorimit në terren pas zhvillimit të aktivitetit.

2.3. Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HP në tri vitet e kaluara

Nga analiza e kontratave të mëhershme janë paraqitur të dhënat mbi çmimet njësi për mirëmbajtjen e HP në tabelën në vijim:

Tabela 6: Mirëmbajtja e HHP në periudhën 2012-2013

HHP sipas tipologjisë	Njësia / m ²	Çmimi njësi mes. €/m ²	Çmimi i mirëmb. se HHP
Parqe / gjelbërime	216445 (4218m ² të mirëmbajtura)	9.96 (Ju lutemi bëni ndarjen e buxhetit, posaçërisht për mirëmbajtjen e HHP)	36,060.00 €
Parkingje	N/A		
Sheshe	620		
Të ndryshme	N/A		
Tregje	N/A		
Varreza	41559		
Gjithsej për mirëmb. e HP			

Tabela 7: Mirëmbajtja e HHP në periudhën 2014-2015

HHP sipas tipologjisë	Njësia / m ²	Çmimi njësi mes. €/m ²	Çmimi i mirëmb. se HHP
Parqe / gjelbërime	216445(4218m ² të mirëmbajtura)	9.96 (Ju lutemi bëni ndarjen e buxhetit, posaçërisht për mirëmbajtjen e HHP)	42,000.00 €
Parkingje	N/A		
Sheshe	620		
Të ndryshme	N/A		
Tregje	N/A		
Varreza	41559		
Gjithsej për mirëmb. e HHP			


Tabela 8: Vlerësimi i mirëmbajtjes së HHP (2016-2017)

HHP sipas tipologjisë	Njësia / m ²	Çmimi njësi mes. €/m ²	Çmimi i mirëmb. se HHP
Parqe / gjelbërime	216445 (4218m ² të mirëmbajtura)	9.96 (Ju lutemi bëni ndarjen e buxhetit, posaçërisht për mirëmbajtjen e e HHP)	42,000.00 €
Parkingje	N/A		
Sheshe	620		
Të ndryshme	N/A		
Tregje	N/A		
Varreza	41559		
Gjithsej për mirëmb. e HHP			


2.4. Të dhënat grafike dhe tabelore mbi HHP ekzistuese

a) Të dhënat grafike


Raporti i sipërfaqeve sipas PZHU




Hapësirat e Hapura Publike



Parqet



Sheshet



b) Të dhënat tabelore

Tabela 9: Të dhënat për parqet

Nr.	Parqet (Emri ose kodi)	Sip. në m ²	Vlerësimi (vjetor) Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Kostoja (vjetore) Çmimi në €/m ²
1	Ahmet Shtimja	1413	7427.89 €	5.26 €
2	Muzeqinë	446	241.64 €	0.54 €
3	Petrovë	1898	2089.1 €	1.10 €
4	Rashnicë	333	292.44 €	0.88 €
5	Parku QKMF	1691	2404.75 €	1.42 €
6	Parku i Pishave	203966	644.90 €	0.01 €
7	Parku i Komandant Kumanova	494	1389.78 €	2.83 €
8	Parku te qendra rinore	8881	710.48 €	0.08 €
		219122	15209.98 €	1.51 €

Tabela 10: Të dhënat për drurendet

Nr.	Sheshet (Emri ose kodi)	Nr. i drunjëve	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Çmimi në €/copë
1	Drurendet	168	1596.0 €	9.5 €

Tabela 11: Të dhënat për sheshet

Nr.	Sheshet (Emri ose kodi)	Sip. në m²	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Çmimi në €/m²
1	Sheshi i UÇK-së	232	856 €	3.69 €
2	Sheshi i Dëshmorëve	388	1564.32 €	4.03 €
		620	2420.32 €	3.86 €

Tabela 12: Të dhënat për varrezat


Nr.	Varrezat (Emri ose kodi)	Sip. në m²	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Çmimi në €/m²
1	Varrezat e Dëshmorëve në Shtime	19796	12739.28 €	0.64 €
2	V. Muslimane	21763	6351.27 €	0.29 €
3	V. Ortodokse	2359	704.11 €	0.30 €
4	V. D. Mollopolc	16368	10505.14 €	0.64 €
5	K. M. Reçak	12917	8862.76 €	0.69 €
		73203	39162.56 €	0.51 €

Tabela 13: Vlerësimi i koston vjetore për mirëmbajtjen e HHP

	HP sipas tipologjisë	Sipërfaqja/Sasia	Vlerësimi vjetor (€)	Çmimi mesatar për njësi (€)
	Parqet	219122 (m²)	15209.98	0.07
	Drurendet	168 (cope)	1616.16	9.62
	Sheshet	620 (m²)	2420.32	3.86
	Varrezat	73203(m²)	39162.56	0.53
	Gjithsej HP në m²	292945 m² HHP + 168 drunjë	59144	3.53 (0.20 €)

Figura 3: Paraqitja grafike e koston në raport me tipologjinë e HHP

Kosto e mirëmbajtjes së HHP ekzistuese



2.5. Analiza e aktiviteteve të mirëmbajtjes për fushat e mirëmbajtjes

- Aktivitetet e pastrimit përfshijnë aktivitetet në grumbullimin dhe largimin e mbeturinave, grumbullimin e gjetheve, pastrimin e kanaleve të kullimit, pastrimin e grafitëve, pastrimin e shtigjeve, fontanave, etj.
- Aktivitetet e hortikulturës përfshijnë aktivitetet e ujitjes, kositjes, mbjelljes, plehërimit, ajrosjes, mirëmbajtjes së gjelbërimit të ulët, gjelbërimit të mesëm dhe të lartë, dezinfektimit, etj.
- Aktivitetet e mirëmbajtjes së ambientit të ndërtuar në kuadër të hapësirave publike, siç janë: mirëmbajtja e shtigjeve, mobilierisë urbane, këndit të lojërave, fontanave, sistemit të ujitjes, mirëmbajtja e përmendoreve, mirëmbajtja e ndriçimit, etj.

3. VIZIONI, OBJEKTIVAT DHE STRATEGJIA MBI HP

3.1. Vizioni i komunës mbi HHP

Deklarata e vizionit për komunën e Shtimes nga PZHK

“Komunë me administratë efikase, shërbime cilësore në arsim dhe shëndetësi, hapësira rekreative, ndërtime të planifikuara, zhvillim të qëndrueshëm mjedisor, përkujdesje ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore, zhvillim ekonomik të balancuar me bujqësi të avancuar, kushte të mira për investitorët - bizneset dhe infrastrukturë bashkëkohore.”

Deklarata e vizionit për mirëmbajtjen e HHP për Komunën e Shtimes

“Komuna që ofron Hapësira të Hapura Publike të sigurta, të qëndrueshme dhe tërheqëse për qytetarët.”

3.2. Synimet dhe objektivat për mirëmbajtjen e HHP

Synimi 1: Ngritja e cilësisë së mirëmbajtjes për periudhën afatmesme.

Objektivi 1: Ngritja e mirëmbajtjes në standard të dëshirueshëm nëpërmjet zbatimit të planit për mirëmbajtje, përkatësisht aktiviteteve të mirëmbajtjes.

Synimi 2: Promovimi i HHP.

Objektivi 2: Sensibilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e HHP përgjatë periudhës afatmesme (2016- 2021).

4. PLANI FINANCIAR

Plani vjetor i mirëmbajtjes bazohet në buxhetet aktuale të KK Shtime për krijimin e mundësisë për ofrimin e cilësisë në nivel të kënaqshëm të HHP. Pikënisja e planit financiar është të mundësohet mbulimi i kostove të mirëmbajtjes për aktivitetet e planifikuara vjetore të mirëmbajtjes. Plani për mirëmbajtje për periudhën e planit 2015-2019 përfshinë të gjitha hapësirat publike ekzistuese, po ashtu edhe të gjitha kostot e mirëmbajtjes së HHP të cilat do të ndërtohen ose investimet e reja në hapësirat si pjesë e planit të investimeve për periudhën e planit.

Plani i mirëmbajtjes për periudhën e planit 2016-2019 bazohet në katër kategori:

- Varreza
- Park
- Shesh
- Drurende

Hapësirat e Hapura Publike në vitin 2016 përfshijnë:

- Sipërfaqet e HHP aktuale përfshijnë nga 171.348 m².
- Numri i Hapësirave të Hapura Publike është 18
- Vlera e përlogaritur e kostove vjetore të hapësirave të mirëmbajtura është 59.144 Euro
- Vlera mesatare mujore e kostove të mirëmbajtjes është 4.929 Euro
- Kostot e mirëmbajtjes së ambientit të ndërtuar janë në vlerë prej 11.4000 (19.3% prej totalit të kostove vjetore)
- Kostot e aktiviteteve të pastrimit janë në vlerë prej 9.197 (15.5% prej totalit të kostove vjetore)
- Kostot e aktiviteteve të hortikulturës janë në vlerë prej 38.547 (65.7% prej totalit të kostove vjetore)

Tabela përmbledhëse e mirëmbajtjes vjetore të HHP

Tabela 14: Tabela përmbledhëse e mirëmbajtjes vjetore të HHP

Numri i hapësirave	18
Vlera e vjetore e mirëmbajtjes	59,144
Vlera e mesatare mujore e mirëmbajtjes	4,929

Kategoritë e mirëmbajtjes		Në % Euro	m²	Në % m²	Numri i HHP
Varreza	40,247	68.0%	133,588	78.0%	5
Park	15,833	26.8%	36,968	21.6%	9
Shesh	2,420	4.1%	742	0.4%	2
Drurende	645	1.1%	50	0.0%	2
Total	59,144	100.0%	171,348	100.0%	18

Sipërfaqet e mirëmbajtura	Në Euro	Në %	Në m²	Kosto për
AN-Ambienti i ndërtuar	11,400	19.3%	482	23.63
AP-Aktivitetet e pastrimit	9,197	15.5%	102,108	0.09
H-Aktivitetet e hortikulturës	38,547	65.2%	68,757	0.56
Total	59,144	100.0%	171,348	0.35

Sipërfaqet e mirëmbajtura	janar-qershor 2016	Korrik-Dhjetor/2016	jan-qersh.2016 në %	Korrik-Dhjetor/2016 në %
AN-Ambienti i ndërtuar	7,221	4,180	63.3%	36.7%
AP-Aktivitetet e pastrimit	5,064	4,133	55.1%	44.9%
H-Aktivitetet e hortikulturës	19,455	19,092	50.5%	49.5%
Total	31,739	27,405	53.7%	46.3%

Kostot e bazuara në periudhën e vitit

Periudha	Vlera	Në %
janar-qershor 2016	31,739	53.7%
Korrik-Dhjetor/2016	27,405	46.3%
Total	59,144	100.0%

Mirëmbajtja mujore -2016

Viti/2016	Vlera e mirëmbajtjes	Në %
Janar	62	0.1%
Shkurt	671	1.1%
Mars	8,446	14.3%
Prill	4,313	7.3%
Maj	8,438	14.3%
Qershor	9,809	16.6%
Korrik	8,642	14.6%
Gusht	8,521	14.4%
Shtator	5,010	8.5%
Tetor	5,043	8.5%
Nëntor	147	0.2%
Dhjetor	41	0.1%
Total	59,144	100.0%


4.1. Nevoja për buxhet të ri për mirëmbajtje të vazhdueshme

Struktura e kostove të mirëmbajtjes së HHP në pjesë të madhe përfaqësohet nga aktivitetet e hortikulturës të cilat janë në vlerë prej 38.547 Euro, e shprehur në përqindje 65.2%, nga totali i shpenzimeve. Përqendrimi i lartë i kostove të hortikulturës bazohet në nevojat për mirëmbajtjen e zonave të gjelbëruara.

Tabela 15: Mirëmbajtja në bazë të kategorive

Kategoria	Total	Në %
AN-Ambienti i ndërtuar	11,400	19.3%
AP-Aktivitetet e pastrimit	9,197	15.5%
H-Aktivitetet e hortikulturës	38,547	65.2%
Total	59,144	100.0%

Figura 4: Paraqitja grafike e mirëmbajtjes në bazë të kategorive



Kostot e mirëmbajtjes janë intensive në periudhën maj-shtator të vitit dhe varen nga sezoni i aktiviteve të hortikulturës. Kostot e pastrimit janë të shpërndara përgjatë tërë vitit dhe janë më intensive në periudhën maj-shtator të vitit.

Tabela 16: Mirëmbajtja mujore në bazë të kategorive

Kategoria	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Total	Në %
AN-Ambienti i ndërtuar	21	21	7,158	-	-	21	21	60	336	3,742	21	-	11,400	19.3%
AP-Aktivitetet e pastrimit	41	41	157	783	1,413	2,628	1,546	1,392	830	198	126	41	9,197	15.5%
H-Aktivitetet e hortikulturës	-	610	1,132	3,530	7,025	7,159	7,075	7,069	3,845	1,104	-	-	38,547	65.2%
Total	62	671	8,446	4,313	8,438	9,809	8,642	8,521	5,010	5,043	147	41	59,144	100.0%
Në %	0.1%	1.1%	14.3%	7.3%	14.3%	16.6%	14.6%	14.4%	8.5%	8.5%	0.2%	0.1%	100.0%	

Kostot e analizuara në baza tremujore janë intensive në tremujorin e dytë dhe të tretë, me pjesëmarrje më të madhe në krahasim me tremujorin e parë dhe të katërt kur për shkak të sezonit janë më të ulëta.

Tabela 17: Mirëmbajtja në bazë të kategorive (në baza tremujore)

Kategoria	TM1/2016	TM2/2016	TM3/2016	TM4/2016	Total	Në %
AN-Ambienti i ndërtuar	7,200	21	417	3,763	11,400	19.3%
AP-Aktivitetet e pastrimit	239	4,825	3,768	365	9,197	15.5%
H-Aktivitetet e hortikulturës	1,741	17,714	17,989	1,104	38,547	65.2%
Total	9,180	22,560	22,173	5,232	59,144	100.0%
Në %	15.5%	38.1%	37.5%	8.8%	100.0%	

Kostot e mirëmbajtjes, bazuar në periudhën gjysmë vjetore, janë më të larta në pjesën e parë të vitit janar-qershor, me pjesëmarrje prej 53.7% të kostove të përgjithshme vjetore. Aktivitetet e hortikulturës nuk kanë ndonjë efekt të kostove për dy periudha dhe janë të shpërndara proporcionalisht, ndërsa kostot e ambientit të ndërtuar janë më intensive në pjesën e parë të vitit.

Tabela 18: Mirëmbajtja në bazë të kategorive (në baza gjysmë vjetore)

Kategoria	Jan-Qersh/2016	Korrik-Dhjetor/2016	Total	Në %
AN-Ambienti i ndërtuar	7,221	4,180	11,400	19.3%
AP-Aktivitetet e pastrimit	5,064	4,133	9,197	15.5%
H-Aktivitetet e hortikulturës	19,455	19,092	38,547	65.2%
Total	31,739	27,405	59,144	100.0%
Në %	53.7%	46.3%	100.0%	

Figura 5: Paraqitja grafike e mirëmbajtjes në bazë të kategorive




Tabela 19: Vlera e mirëmbajtjes në bazë të kategorive

Kategoria	Varreza	Park	Shesh	Drurende	Total
AN-Ambienti i ndërtuar	7,451	3,075	874	-	11,400
AP-Aktivitetet e pastrimit	5,104	3,257	836	-	9,197
H-Aktivitetet e hortikulturës	27,692	9,500	711	645	38,547
Total	40,247	15,833	2,420	645	59,144
Në %	68.0%	26.8%	4.1%	1.1%	100.0%

Kostot e bazuara në llojin e hapësirave të hapura publike janë të përqendruara në mirëmbajtjen e varrezave në vlerë vjetore të mirëmbajtjes prej 40.247 Euro, e shprehur në përqindje 68.8 %.Pjesëmarrja e madhe e kësaj kategorie është detyrim i madh buxhetor, i cili e pamundëson mirëmbajtjen e numrit më të madh të hapësirave të hapura publike.

Kategoria e hapësirave të hapura publike për kategorinë e kostos vjetore të mirëmbajtjes së varrezave:


- K. M. Reçak 10,539 (26.2%)
- V. Ortodokse 94 (0.2%)
- V. D. Mollopolc 10,523(26.1%)
- V. Muslimane 6,351 (15.8%)
- Varrezat e Dëshmorëve 12,739 (31.7%)

Tabela 20: Raporti i kostos dhe sipërfaqeve

Kategoria	Vlera	Vlera%	m2	m2%
Varreza	40,247	68.8%	133,588	78.0%
Park	15,833	27.1%	36,968	21.6%
Shesh	2,420	4.1%	742	0.4%
Drurende	645	1.1%	50	0.0%
Total	58,500	100.0%	171,297	100.0%

Figura 6: Struktura e kostove vjetore

Struktura e kostove vjetore të mirëmbajtjes



4.2. Rrjedha e parasë (cash flow) e kostove të mirëmbajtjes dhe përlllogaritja e kostove të sezonit

